

Dhuna familjare

**Dëbimi (largimi) policorë
dhe kthimndalimi**

E drejta penale

**Masat mbrojtëse të së
drejtës civile**



Këtë broshurë informative të Projekteve Intervenuese në Graubünden kundër dhunës në familje mund ta merni falas te çdo stacion policorë si dhe te pozicioni i stafit për barazi të shanseve të gruas dhe burrit në kantonin e Graubündenit.

Broshura mund të merret edhe nga faqja e internetit të pozicionit të stafit për barazi të shanseve www.stagl.gr.ch në gjuhët vijuese: gjermanisht, italisht, retoromanisht, shqip, anglisht, portugalisht, sërbiisht/kroatisht, spanjollisht, tamile dhe turqisht.

Dhuna në familje nuk do të tolerohet!

Dhuna në zonën shtëpiake nuk është gjë private dhe nuk tolerohet. Arsyetimet si trivializimi, alkooli, stresi, provokimi nuk do të pranohen. Përgjegjësia për dhunën qëndron gjithnjë tek personi, i cili e ushtron atë. Personat e prekur nga dhuna kanë të drejtë për mbrojtje dhe ndihmë.

Fëmijët, të cilët rriten në një rreth të karakterizuar me dhunë, pengohen shumë në zhvillimin e tyre. Atyre ju duhet mbështetje speciale dhe vëmendje. Merr policia njohuri mbi dhunë në familje, e paraqet rrezikimin e të mirës së fëmijës menjëherë zyrës së kujdestarisë.

Kjo broshurë ju përgjigjet pyetjeve më të rëndësishme mbi dhunën familjare. Në kartën e rasteve urgjente gjeni adresat e ofertave ndihmëse dhe institucioneve më të rëndësishme.

Këto oferta ju qëndrojnë juve 24 orë në dispozicion:

Çfarë mund të bëni, nëse jeni të prekur nga dhuna?

Në një situatë akute të rrezikut duhet të kërkonit menjëherë policinë për mbrojtje gjegjësisht ndihmë:

Notruf (Thirja urgjente) 117

Policia mund ti dëbojë personat, nga të cilët rrjedh dhunë për të tjerët, prej banesës/shtëpisë së përbashkët, dhe prej rrethit të afërt. Ju si person i prekur nga dhuna dhe fëmijët tuaj keni të drejtën të rrini në rrethin e juaj të zakonshëm.

Ku mund të informoheni, të mbështeteni dhe të këshilloheni?

qendra këshilluese për ndihmë viktimave në kantonin e Graubünden (Opferhilfe-Beratungsstelle des Kantons Graubünden) 081 257 31 50

Qendra për këshillime ju informon, mbështet dhe ju këshillon juve në pyetje personale dhe juridike dhe ju propozon, nëse është e nevojshme, që të merni edhe qendra dhe/ose persona tjerë profesionalë në dispozicion.

Këshillimi është falas. Kërkesat e juaja do të trajtohen me besueshmëri. Punëtorët/et përgjegjës qëndrojnë nën sekretin profesional. Këshillimin ju mund ta ndërpreni në çdo kohë.

Kërkonit ju mbrojtje, ndihmë dhe këshillim?

shtëpia e grave Graubünden (Frauenhaus Graubünden) 081 252 38 02

Shtëpia e grave ju ofron grave, fëmijëve tuaj dhe të rejave femra, të cilat janë të prekur nga dhuna, pranim, mbrojtje dhe këshillim

A keni rrahur apo jeni kërcënuar për dhunë?

Qendra këshilluese për personat që ushtrojnë dhunë (Beratungsstelle für Gewalt ausübende Personen) 079 544 38 63

Në ju ndihmojmë juve në zhvillimin e një sjelljeje pa dhunë në raste konfliktesh. Këshillimi është falas. Kërkesa juaj trajtohet në mënyrë të besueshme.

Përgjigje në pyetjet më së shpeshti të parashtruara

Dëbimi dhe kthimndalimi nga ana e policisë

Kë e mbron ligji?

Secilin person, që përjeton dhunë familjare, pa marrë parasysh nëse dhuna ushtrohet në bashkëshortësi, në mes të partnerëve ose në familje. Personi i prekur nga dhuna duhet të banojë në kantonin e Graubünden. Mysafirët në pushime kanë të njëjtën të drejtë për mbrojtje në vendndodhjen e tyre.

Kush mund të dëbohet?

Personat, të cilët bashkëbanorët dhe bashkëbanoret i rrezikojnë në mënyrë serioze. Për të miturit që ushtrojnë dhunë, dëbimi nuk është adekuat. Në këto raste duhet të gjindet një zgjidhje adekuate me zyrën e kujdestarisë.

Sa kohë vlen kthimndalimi policorë?

Për zgjatje e urdhëruar nga policia, maksimalisht 10 ditë.

A mund të zgjatet afati i kthimndalimit?

Po. Personi i rrezikuar duhet brenda kohëzgjatjes së largimit të bëjë kërkesë te kryesia e gjyqit të qarkut, për masa superprovizore në kornizat e mbrojtjes së martesës (tek të martuarit) ose sipas Art. 28b ZGB ff. masa për të ndejtur larg.

Si mund të mbrohet personi i dëbuar kundër dispozitës (vendimit)?

Gjatë kohëzgjatjes së dëbimit ky urdhër mund të kundërshtohet te kryesia e gjyqit të qarkut.

A mvaret dëbimi nga dëshira e viktimës?

Jo. Nëse viktima nuk dëshiron dëbimin nga frika apo turpi, policia do të urdhërojë prapë se prapë një gjë të tillë, nëse ekziston një rrezikim serioz. Dëbimi është një masë sigurie policore.

A është e rëndësishme se kujt i takon shtëpia/banesa?

Jo. Policia mund të dëbojë secilin person i cili paraqet rrezik.

Çfarë ndodh me çelësat e banesës?

Policia ia mer personit të dëbuar çelësat dhe ja dorëzon viktimës.

A obligohet personi i dëbuar të jetë i arritshëm për policinë?

Po. Policia kërkon nga ky person, që të jep një adresë për dërgimin e letrave zyrtare.

Çfarë guxon të marrë me vete personi që dëbohet?

Gjëra që i duhen patjetër për nevojën personale (p.sh. dokumente personale, veshje, letërnjoftimin, medikamente).

Çfarë mund të bëjë viktimja, nëse për shkak të dëbimit ajo nuk ka më para për familjen?

Nëse personi që dëbohet është i obliguar për tu kujdesur për mirëmbajtjen e familjes, atëherë ky duhet që gjatë kohës së dëbimit të sigurojë paratë e nevojshme. Përndryshe duhet të sigurohet një urë (ndihmë) me anë të entit social.

Për cilën hapësirë vlen kthimndalimi?

Për banesë/ shtëpi dhe rrethinën e afërt. Këtu bëjnë pjesë p. sh. hyrjet, shkallët e shtëpisë, podrumi, lavanderia, oborri, kopshti, dhe hyrje-daljet e shtëpisë. Policia duhet ta definojë qartas vendin e mbrojtur në dokumentin dispozitues për dëbim. Personi i rrezikuar merr një kopje të dokumentit dispozitues me shkrim për dëbim.

Çfarë ndodh nëse ushtruesi i dhunës nuk largohet vullnetarisht?

Policia mund ta detyrojë largimin e personit që ushtron dhunë.

A mund ti jepet një personi urdhëri për largim dhe kthimndalim, pasi që policia më vonë ka ndëgjuar për një dhunë të tillë?

Po, nëse egziston frika se personi i prekur nda dhuna do të përfytyrojë malltetime tjera.

A do të kontrollohet nëse ky kthimndalim respektohet?

Policia ka të drejtë të kontrollojë çdo moment nga ana e tyre nëse ky rend respektohet.

Çfarë mund të bëni ju, nëse personi i dëbuar nuk i përmbahet regullave të kthimndalimit?

Në këtë rast, duhet menjëher të telefononi policinë. Policia e largon të dëbuarin sipas nevojës edhe me forcë. Ky depërtim paraqet për më tepër një veprim penal (mosndëgjim i dispozitave zyrtare) dhe dënohet me gjobë.

A mund të kthehet personi i dëbuar sërish në shtëpi pasi që është qetësuar?

Jo, jo brenda kohëzgjatjes zyrtare të dekretuar. Edhe nëse viktimja është dakord për një kthim të tillë, personi i dëbuar mund të ndëshkohet.

Nëse personi i dëbuar dëshiron të merr edhe gjëra tjera nga banesa?

Nëse personi i dëbuar duhet të merr patjetër gjëra të nevojshme në banesë, kjo guxon të ndodhë vetëm në prezencën e policisë.

Dëshironi që qendra këshilluese për ndihmë viktimës të marrë kontakt me ju?

Ju duhet të jepni pëlqimin tuaj me shkrim, që policia të mund që të dhënat tuaja personale ti dërgoj te qendra për këshilla. Kjo qendër pastaj merr kontakt me ju.

Ju mundeni çdo kohë ti drejtoheni qendrës për këshillime, edhe nëse ju në fillim e keni rrefuzuar një kontakt të tillë.

Ku mund të marrë këshilla personi i dëbuar?

Personi i dëbuar paraqitet te qendra këshilluese për personat që ushtrojnë dhunë (Beratungsstelle für Gewalt ausübende Personen). Qendra këshilluese merr kontakt me personin që ushtron dhunë dhe i ofron atij një këshillim.

Ky këshillim mund të merret në dispozicion falas nga të gjithë personat, që dëshirojnë të përpunojnë problematikën e tyre me dhunën.

Kur informohet organi zyrtarë për përkujdesje (Vormundschaftsbehörde)?

Policia paraqet rastin te organet zyrtare për përkujdesje për sqarim, nëse fëmijët jetojnë në shtëpinë përkatëse.

A mund ta marr policia një person që ushtron dhunë në arrest (kujdestari)?

Po, nëse ai qëndron nën ndikim të alkoolit ose drogës, ose lë të kuptohet që ai nuk do të praktikojë dispozicionin për dëbim. Shpesh mjafton dëbimi me kthimndalim, që një rrezik të shmanget ose sëpaku të zvogëlohet.

A mundet që dëbimi me kthimndalim dhe arresti policorë të zbatohen në të njëjtën kohë?

Po. Edhe nëse personi që ushtron dhunë sëpari është marrë në arrest (kujdestari), mund të shprehet një dëbim me kthimndalim. Mu në këto raste një ndalim nga ana e policisë është shumë e rëndësishme, ngase një kthim në banesën e përbashkët sjell shpesh deri te një eskalim i situatës.

A e humbi lejeqëndrimin tim, nëse burri im ose gruaja ime dëbohet nga ana e policisë?

Jo. Për kohën e dëbimit policorë nuk shiqohet tërheqja e lejeqëndrimit. Në raste të ndarjes më të gjatë ju propozojmë një këshillim individual te qendrat këshilluese. Vërtetimi i dhunës familjare që keni përjetuar mund të jetë i rëndësishëm bashkë me faktorë tjerë, për mbajtjen e lejeqëndrimit.

Fëmijë në mes – fëmijët si dëshmitarë të dhunës familjare

Fëmijët ja edhe si dëshmitarë gjithnji të involvuar në dhunën familjare. Bashkëpërjetimi i dhunës ndërmjet partnerëve i dëmton fëmijët në situata akute si dhe në zhvillimin e tyre kognitiv, social dhe emocional. Ata bëjnë, edhe nëse ato nuk rrihen direkt, një rrezik të madh për përjetime të mëvonshme me dhunë – goftë ajo si viktimë apo si person ushtrues i dhunës.

Policia do të bëjë një paraqitje tek organet zyrtare për përkujdesje në raste dhune, pamvarësisht se a shprehet një dëbim.

Qendra profesionale për mbrojtjen e fëmijëve (Fachstelle Kinderschutz) ju këshillon dhe ju informon për mundësitë e përshtatshme terapike për fëmijën tuaj.
gen - sei dies als Opfer oder als Gewaltausübende.

Dhuna familjare në të drejtën penale.

Ligji i kodit penal zvicëran i dënon shumë lloje, por jo të gjitha llojet e dhunës familjare. Të prekurit shpeshherë kanë nevojë për përkujdesje shëndetësore, këshillime, mbrojtje të drejtës civile dhe përkrahje financiare.

Si mund të duket dhuna familjare?

P. sh. shuplakë, shqelzim, grushtim, kafshim, gervishtje,rahje, zërje fryme, nxjerja e një arme, kërcënim, detyrim të një sjellje të caktuar, mbyllje me cels nga jashtë, mbikëqyrje, goditje me mjete pune, therje me thikë, qëllim me armë.

Cfar do të thotë ndjekje nga ana e organeve zyrtare?

Përndjekje nga ana e organeve zyrtare do të thotë, që viktimia vet, nuk obligohet më që brenda tre muajve të bëjë një kallëzim penal, në mënyrë që ushtruesi i dhunës të paraqitet para organeve të drejtësisë. Policia nga ana e vet dhe atë pamvarësisht nga dëshira e viktimës është e obliguar ti zhvilloj hetimet.

Cilat raste të dhunës familjare ndjeken vetë nga organet shtetërore (delikte zyrtare)?

Lëndimet e lehta të kualifikuara (të ushtruara me një mjet të rrezikshëm, helm ose me një armë) dhe lëndimet e rënda trupore, detyrimi, detyrimi seksual, perdhunimi dhe delikte vrasjeje ndjeken pamvarësisht nga marrdhënja viktimë/autor i krimit vetë nga organet zyrtare.

Dhuna familjare në formë të një lëndimi të lehtë , veprimet e përsëritura dhe kërcënime ndërmjet bashkëshortëve, partnerëve të regjistruar homoseksual dhe çiftve konkubinats hetero- dhe homoseksual ndjeket poashtu vetë nga ana e organeve zyrtare. Kjo mbrojtje e rritur vlen për bashkëshortë dhe partnerë të regjistruar deri një vit pas divorcit gjegjësisht pas zgjidhjes ndërmjet partnerëve dhe për partnerët e jetës qofshin ato hetero- apo homoseksual deri një vit pas ndarjes.

Jashta një martese, partneritet të regjistruar ose të një konkubinats duhet për këto delikte të bëhet gjithnjë një padi penale.

Cilat delikte të dhunës familjare ndjeken vetëm me anë të padisë të personave të prekur nga dhuna (delikte ku kërkohet padi)?

Për shembull: dëmtim material, veprim i njehershëm, prishje qetësie në shtëpi, keqpërdorim i telefonit, vardisje seksuale.

E nëse fëmijët janë të prekur?

Dhuna e të rriturve ndaj fëmijve, të cilët gjenden nën mbikëqyrjen tuaj ose për të cilët duhet të kujdeseni, ndjeket nga ana e organeve zyrtare.

Masat mbrojtëse të së drejtës civile

Çiftet bashkëshortore / partnerë të regjistruar

Nëse dëshironi që kthimndalimi të vazhdojë më gjatë se zgjatja e urdhëruar nga policia, atëherë duhet të bëheni ju aktiv dhe duhet të dorëzoni te kryesia e gjyqit të qarkut një kërkesë për masa mbrojtëse në bashkëshortësi / masa rregullash të përkohshme*. Kjo kërkesë mund të parashtrohet edhe pa intervenim të mëhershëm të policisë.

Çfarë aplikimesh mund të bëhen?

Për shembull:

- Caktimi i banesës/shtëpisë bashkëshortore
- Ndalim hyrje në banesë/shtëpi dhe në rrethinën e afërt
- Ndalim afrimi dhe kontaktimi
- Caktimi mbi të drejtën e mbikqyrjes së fëmijve/rregullat e të drejtës së vizitës
- Përcaktimi për mbulimin e shpenzimeve të jetës

Si mund të vërtetohet dhuna?

Dhuna familjare duhet të vërtetohet në formë të besueshme.

Dëshmi të mundshme janë:

- Vërtetime mjekësore / fotografi nga plagët ärztliche
- Letra/ SMS
- Gjykime (të mëhershme) / të dhëna për ndërhyrje policore / dekrete për dëbim
- Informata me shkrim nga qendra këshilluese dhe nga shtëpitë e grave

A do të merret në pyetje personi i dëbuar në lidhje me kërkesën tuaj?

Po. Personi i dëbuar ka të drejtën të dëgjohet dhe të paraqes kërkesat e tij dhe të sjell prova materiale. Gjyqi, sipas rregullit, vendos pasi që dëgjon të dy palët në konflikt.

Çfarë janë urdhërat superprovisore?

Në raste urgjente, gjyqi para se të dëgjojë palën tjetër, mund të urdhërojë për të njëjtën kohëzgjatje si edhe procesi, masa superprovisore. Ai mund të caktojë për shembull, që banesa ti takojë personit në rrezik dhe që vlen një ndalimhyrje deri në vendimin definitiv. Këto kërkesaj janë të rëndësishme. Kështu ju e shmangni që të ketë një hapësirë ndërmjet dëbimit dhe të masave mbrojtëse në bashkëshortësi / masave rugullore.

A do të konfrontoheni ju gjatë procesit të gjyqit me personin e dëbuar?

Gjykata mund t'ie ftoj palët në një bisedë gojore. Në ju për shkaqe psikike nuk jeni në gjendje, të takoni personin që ka ushtruar dhunë, preferohet që biseda të bëhet ndaras dhe të shmanget konfrontimi direkt.

Kush merr përsipër shpenzimet e gjyqit dhe të avokatit?

Nëse mungojnë mjetet për pagesën e procedurës gjyqësore dhe të avokatëve, mund të bëhet një kërkesë të gjykata për lirim nga kjo pagesë. Kjo nevojë duhet të dëshmohet me të dhëna mbi gjendjen financiare.

Çfarë mund të bëni, nëse personi i dëbuar e keqpërdor ndalesën gjyqësore?

Thireni menjëherë policinë dhe tregoni vendimin gjyqësor. Policia do të largojë personin kundërvajtës.

Partnerët në bashkëjetesë / bashkësi në banim / Ish-çifte / stalking

Ju jetoni bashkë me një person që ushtron dhunë në një konkubinatin apo bashkësi në banim. Ju kërcënoheni nga ish-partneri apo ish-partnerja juaj. Një person, me të cilin ju nuk qëndroni në asnjë marrëdhënie, ju kërcënon ose ju ndjek.

Prej 1. korrik 2007 nuk luan rol, se në çfarë marrëdhënie ju qëndroni me një person, i cili kundër jush përdor dhunë, ju kërcënon ose ju ndjek. Ju mund të bëni një kërkesë të gjyqi i qarkut për ndalim afrimi, ndalim lagje dhe/ose ndalim kontakti për mbrojtje nga dhuna, kërcënimi ose ndjekja. (Art. 28b ZGB). Gjyqi i qarkut mund përveç asaj të dëbojë nga banesa personin që ushtron dhunë, nëse banoni bashkë me të. Këto masa mund ti kërkonit edhe si mënyrë preventive. Gjyqi i qarkut e vëndon një afat, gjatë të cilit ju duhet të ngreni padi. Nëse ngreni padi, do të ngrehen të gjitha masat e urdhëruara.

Në raste urgjente dhe nëse ekziston një dëbim policorë, gjyqi mund të caktojë para ndëgjimit të palës tjetër për kohëzgjatje të procesit urdhëra superprovisore. Kështu e shmangeni, që të lind një hapësirë ndërmjet dëbimit dhe të masave mbrojtëse.

Kujdesuni për sigurinë tuaj!

Caktimet e reja ligjore ofrojnë më shumë mbrojtje për të prekurit dhe përveç asaj ofrojnë mundësinë, që të rrijë në rrethin e zakonshëm. Ata nuk ofrojnë mbrojtje të sigurtë nga dhuna! Në situata të rrezikshme mund të jetë e rëndësishme, që ju dhe femijët tuaj megjithatë të lëshoni banesën dhe të kërkonit një strehim të sigurt (shtëpia e grave), sëpaku deri sa të kalojë koha e rrezikshme. Në kohët e ndarjes dhe divorcit rriten sipas përvojës edhe veprimet me dhunë. Faktorët që e rritin rrezikimin janë posedimi i armëve, konsumimi i drogës dhe alkoolit, kërcënimet, kërcënimet për vetvrasje, xhelozitë e sëmurë dhe mendimi për posedim. Lirimi nga situatat e keqtrajtimit është shumë i vështirë dhe shpesh shumë i ngadalshëm. Ju duhet në çdo rast të merrni ndihmë nga jashtë dhe të ndërtoni një rrjetë për përkrahje.

Impressum:

Konzept, Text, Redaktion: Susanna Mazzetta, Bettina Joos

Fachliche Begleitung: Runder Tisch des Bündner Interventionsprojekts gegen Häusliche Gewalt, Arbeitsgruppe Broschüre
3. überarbeitete Auflage 2011

In Kooperation mit der Kantonspolizei Graubünden.

Bündner Interventionsprojekt gegen Häusliche Gewalt
Loestrasse 37, 7000 Chur



KARTA E RASTEVE URGJENTE

Në raste dhune në bashkëshortësi, në mesin e partnerve dhe në familje

A ndjeheni e pasigurt në lidhjen tuaj?

A ndjeheni të kërcënuar ose dikush ushtron dhunë mbi ju?

Dhuna familjare nuk është problem privat!

Ka ndihmë dhe përkrahje

Për raste urgjente dhe ndihmë në vendin tuaj: Polizeinotruf 117

Këtu mund te informoheni, përkraheni dhe të këshilloheni:

Opferhilfe-Beratungsstelle des Kantons Graubünden

Loestr. 37, 7000 Chur

Tel. 081 257 31 50

24 orë në linjë telefonike

www.gr.ch

Nëse fëmijët janë të prekur direkt nga dhuna:

Kantonsspital Kinderklinik

Tel. 081 256 64 20

Fachstelle Kinderschutz

Tel. 081 257 31 50

Loestr. 37, 7000 Chur

24 orë në linjë telefonike

www.gr.ch

Telefonhilfe für Kinder und Jugendliche

Tel. 147

www.147.ch

Nëse ju duhet mbrojtje, ndihmë dhe këshillim:

Frauenhaus Graubünden

Tel. 081 252 38 02

24 orë hapur

www.frauenhaus-graubuenden.ch

Nëse dikush ka ushtruar dhunë ndaj jush,

duhet të merrni ndihmë medicinale dhe të kërkonin një vërtetim mjekësorë.

Shkoni për këtë te mjeku/mjekja i/e shtëpisë

Tel.....

në raste urgjente: Sanitätsnotruf

Tel. 144

Nëse ndaj juve është ushtruar dhunë seksuale,

mund të drejtoheni më së miri menjëherë pas veprës (në secilën kohë) te shërbimi i urgjencës i spitalit të grave

Frauenspital Fontana (gratë)

Tel. 081 254 81 11

ose në Kantonsspitals (burrat).

Tel. 081 256 61 11

Atje do të merrni ndihmë medicinale dhe përkrahje.

Plagët mund të trajtohen dhe sëmundjet mund të parandalohen.

Mund të bëhet një kontrollim medicinal special, i cili është i rëndësishëm për një proces të mëvonshëm penal.

Mos u lani apo mos bëni dush përpara se të bëhen kontrollat e nevojshme nga mjeku. Gjurmët, edhe nëse janë shumë të vogla, ndihmojnë të gjemë vepruesin.

Për masat mbrojtëse të bashkëshortësisë dhe masat mbrojtëse të së drejtës civile drejtohuni te:

Gjyqi i qarkut	Albula, Tiefencastel	Tel. 081 681 22 36
në vendbanimin	Bernina, Poschiavo	Tel. 081 834 60 42
tuaj:	Hinterrhein, Thusis	Tel. 081 650 07 30
	Imboden, Domat/Ems	Tel. 081 633 12 54
	Inn, Sent	Tel. 081 864 93 33
	Landquart, Landquart	Tel. 081 300 00 60
	Maloja, Samedan	Tel. 081 852 18 17
	Moesa, Roveredo	Tel. 091 827 33 66
	Plessur, Chur	Tel. 081 254 46 60
	Prättigau/Davos, Klosters	Tel. 081 420 27 00
	Surselva, Ilanz	Tel. 081 920 00 40

Burrat dhe gratë, që janë të dhunshëm ose kërcënojnë dhunë, mund të drejtohen te qendra Beratungsstelle für Gewalt ausübende Personen. Këto i përpunojnë me ata format për një zgjidhje të pa dhunshme të konfliktit.

Beratungsstelle für
Gewalt ausübende Personen
Gäuggelistr. 16 / Brunnenhof, 7000 Chur
www.gewaltberatungsstelle.gr.ch

079 544 38 63

Qëndrojnë probleme të mvarësisë (p.sh. alkooli) në qendër ose ju duhet më tepër përkrahje, drejtohuni te

Shërbimi regjional social në regjionin tuaj
Banorët e qytetit të Chur'it, të qarkujve Trin, Rhäzüns, Churwalden dhe Schanfigg mund të drejtohen te Sozialdienst für Suchtfragen,
Loestrasse 37, Chur

Tel. 081 257 2691

Te shërbimi regjional social mund të drejtoheni edhe, nëse përsëri shkak të ndarjes gjendeni në situatë të keqe financiare.

Kur të rinjët ushtrojnë dhunë në familje
Kinder- und Jugendpsychiatrischer Dienst (KJP) Tel. 081 252 90 23
www.kjp-gr.ch

Die Dargebotene Hand (dora e shtrirë), www.143.ch Tel. 143

Informata për grupet vetëndihmuese:

Kontaktstelle für Selbsthilfegruppen
E martë dhe e mërkurë ora 9-11
www.teamselfhilfe.ch

081 353 65 15

Bündner Interventionsprojekt
gegen Häusliche Gewalt
Loestrasse 37, 7000 Chur

